

N J O F T I M:

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.53 datë 30.05.2025, i cili ka miratuar fillimin e procedurave të shpronësimit për pasuritë që preken nga realizimi i projektit me interes publik, *Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit, me interes publik “Rivitalizim Urban i shesheve të pallateve nr. 588, 712 etj., “Aleks Buda”, në lagjen “5 Maj”, Z.K 8525””, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi”*”, si dhe mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, kërkohe që brenda datës 30.06.2025, pronari/ët e pasurive ose të tretë të cilëve i’u preket pasuria, të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Pronave Publike dhe Strehimit, fotokopje të noterizuar të dokumenteve të pronësisë lëshuar nga ASHK Elbasan si dhe fotokopje karte identiteti.